



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 5.03.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë”, në Qarkun Tiranë si dhe verifikimi i mandatit të deputetit z. Ylli Shehu.

2. Shqyrtimi i vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë”, në Qarkun Elbasan si dhe verifikimi i mandatit të deputetit z. Enver Mersin.

3. Shqyrtimi i vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë”, në Qarkun Dibër si dhe verifikimi i mandatit të deputetit znj. Aurora Mara.

4. Shqyrtimi i vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë”, në Tiranë si dhe verifikimi i mandatit të deputetit z. Edmond Rrushi.

Marrin pjesë:

Gramoz Ruçi, Vasilika Hysi, Klotilda Bushka, Ulsi Manja, Damian Gjijnuri

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Fillojmë mbledhjen e sotme të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

Nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve janë depozituar në Kuvend vendimet për dhënien e mandatit të deputetëve të kandidatëve të listës shumëëmërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në qarqet Tiranë, Elbasan dhe Dibër.

Në mbështetje të nenit 13 të Rregullores, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin mblidhet për të bërë verifikimin e mandatit të deputetit që zgjidhet gjatë legjislaturës. Këtë mbledhje të posaçme e zhvillojmë sot për secilin prej kandidatëve që kanë fituar mandatin e deputetit, konkretisht z. Ylli Shehu, z. Edmond Rrushi, z. Enver Roshi dhe znj. Aurora Mara. Materialet i keni të gjithë përpara. A ka ndonjë mendim, ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim nga anëtarët e Këshillit, në lidhje me mandatin e ri të dhënë nga KQZ-ja? Nuk ka. Atëherë, jemi dakord!

Damian Gjiknuri – Më falni zoti kryetar, këto formularët e dekriminalizimit verifikohen apo vetëm dorëzohen?

Mimoza Pano – formularët e dekriminalizimit dorëzohen në KQZ dhe atje nis procesi i verifikimit sipas ligjit.

Gramoz Ruçi – Është e nevojshme që t'i thërrasim kandidatët një nga një këtu?

Damian Gjiknuri – Jo, Kodi Zgjedhor nuk e ka këtë gjë, po as Rregullorja.

Vasilika Hysi – Ju do t'i thërrisni për betim. Nëse nuk e bëjnë betimin mund të vijnë në Këshill. Ata janë në sallë. Ju do t'i thërrisni për të bërë betimin.

Gramoz Ruçi – Me që Këshilli i Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit nuk e ka kuorumin e nevojshëm, raporti duhet votuar në seancë. Kush do ta mbajë raportin?

Mimoza Pano – Raportin do ta mbajë relatorja, znj. Klotilda Bushka.

Gramoz Ruçi – Dhe kjo çështja e kuoromit është shumë e diskutueshme.

Damian Gjiknuri – Nuk ka pse të ketë votim. Ju e konstatoni.

Ulsi Manja – Këshilli i Mandateve paraqet raport. Nuk voton.

Gramoz Ruçi – Dakord, të paraqitet raporti dhe pastaj ta votojmë në seancë plenare.

Klotilda Bushka – Do ta lexojmë në seancë?

Gramoz Ruçi – Po, patjetër. Ka një pikë te Këshilli që thotë se mbledhet sipas rregullave të komisioneve të përhershme. Aty e kemi me kuorum.

Ka një gjë, kur flasim për kuorum flitet sa është kuorumi i Kuvendit. Tani kuorumi i Kuvendit është 78 deputetë dhe jo 140. Kjo është e diskutueshme. Hajde ta interpretojmë, këtu kemi 4 jurista. Po t'i futemi nuk mbarojmë as nesër mbledhjen. Është bërë gati edhe raporti, siç është rregulli, i cili shpreh këtë qëndrim të Këshillit. T'u shpërndahet deputetëve! Mirupafshim!

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA